

VENDIM
Nr. 132, datë 22.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE (KULTURA BUJQËSORE DHE DRU FRUTORË) QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN-VLORË (SEKSIONI I PARË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” dhe të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (kultura bujqësore dhe dru frutorë), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan-Vlorë (seksioni i parë).
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet sipas listave bashkëlidhur, për kultura bujqësore me vlerë 3 093 255 (tre milionë e nëntëdhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, dru frutorë me vlerë 3 304 769 (tre milionë e treqind e katër mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 6 398 024 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 705 000 (një milion e shtatëqind e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 6 398 024 (gjashtë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e njëzet e katër) lekësh, të përballohen nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve për vitin 2012.
 6. Shpronësimi të fillojë nga data 1.3.2012.
 7. Pronarët e listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Pronarët e pasurive, për të cilët në kolonën respektive është bërë shënimi “Të pakonfirmuar” dhe “Proces saktësimi”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë bërë regjistrimet apo të ketë përfunduar procesi i saktësimit nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Fier dhe pasi të jenë konfirmuar të dhënat e plota e të sakta po nga kjo zyrë lidhur me titullin e pronësisë.
 9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve sipas pikave 7 dhe 8 të këtij vendimi.
 10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha